

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Po rrezikohet shembja e fshatit"/ Banorët e Milecit denoncojnë gërmimet për qymyrgurin
ADRESA	https://joq-albania.com/artikull/1393697.html
BURIMI	joq-albania.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 19:00:05 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	23 shtator 2026, 18:51:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 23 shtator 2026, 18:50:00 UTC → 23 shtator 2026, 18:52:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	844eb4e7461244c1435e29a154ac7d27641156b1abc5722766f6f836cc61bd04
TEKSTI	40efdbc9d2b1121796b543f185ec10a453a23d25d82870caa03015821c24dcb5
PAMJA	c5582d3a8363f9ec9848e03d16c5890cba69ff3b623c53229c46255779ebd667

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f0129361823fc1fcb451bfee58fabe00a2a5c74c2af0c328993006a193309e29
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f0129361823fc1fcb451bfee58fabe00a2a5c74c2af0c328993006a193309e29>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

“Po rrezikohet shembja e fshatit”/ Banorët e Milecit denoncojnë gërmimet për qymyrgurin

Shkruar nga: Y Pepa | Publikuar më: 23.09.2026, 20:51



Share



Share



Një banor i fshatit Milec, Njësia Administrative Mollas, Bashkia Ersekë, i është drejtuar redaksisë së JOQ Albania për të denoncuar aktivitetin e një firme private që merret me nxjerrjen e qymyrgurit.

Sipas banorit, firma ka leje shfrytëzimi për tokë shtetërore, por pretendon se gjatë gërmimeve ka ndërhyrë edhe në pronat private të banorëve të fshatit, të ndara sipas Ligjit 7501 dhe për të cilat banorët paguajnë taksat.

Në pamjet e dërguara në redaksi shihen gërmime të thella në terren, eskavatorë dhe kamionë që transportojnë materialin e nxjerrë nga zona.

Banori pretendon se gërmimet kanë dëmtuar gjithashtu rrugën e fshatit dhe lumin, ndërsa sipas tij, rrëshqitjet e tokës kanë nisur të afrohen drejt banesave.

“Firma ka shkatërruar pronat private të fshatarëve, ku po rrezikohen banesat e fshatit. Kanë filluar dhe plasaritje në banesa.”

Ai thotë se banorët janë ankuar prej tre vitesh në Bashkinë Ersekë dhe në Komisaratin e Ersekës. Sipas tij, nga komisarati kanë marrë mbështetje brenda kompetencave të tyre, ndërsa pretendon se bashkia nuk ka marrë masa për ndalimin e aktivitetit.

“Bashkia e Ersekës, që kërkon taksat e tokës dhe jemi pagues të rregullt, nuk merr asnjë masë për ndalimin e tyre.”

Në një tjetër pjesë të videos, banorët shihen pranë zonës së gërmimeve, ndërsa i kërkojnë drejtuesit të mjetit të ndalojë punën.

Pretendimet për kufijtë e lejes së shfrytëzimit, dëmtimin e pronave private, devijimin e lumit dhe rrezikun për banesat kërkojnë verifikim nga institucionet përgjegjëse dhe dokumentacionin përkatës.

Banorët kërkojnë ndërhyrje për të verifikuar aktivitetin e firmës dhe ndikimin e gërmimeve në pronat, rrugën dhe terrenin përreth.

JOQ Albania publikon pamjet dhe denoncimin e banorit, ndërsa mbetet e hapur për reagimin e Bashkisë Ersekë, institucioneve përgjegjëse dhe subjektit që ushtron aktivitetin në zonë.



Më të Lexuarat



Albania për
Media
Etike

ARTIKULL JOETIK?



[View this post on Instagram](#)



A post shared by JOQ News (@joqnews)

FACT CHECK: Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e [raportoni këtu](#).

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR

TË NGJASHME

Më të fundit



Dërgo materialin tënd këtu >

[Puno me ne!](#)

[Marketing](#)

[Politika e privatësisë](#)

[Rreth Nesh](#)

[Kushtet e përdorimit](#)

[Kontakt](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.